



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 09 gusht 2019
Nr. ref.:RK 1405/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI169/18

Parashtrues

Përmbaruesi Privat - Sefer Sh. Arifi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore në ndërlidhje me nenin 247 të Ligjit nr. 04-L/139 për Procedurën Përmbarimore

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sefer Sh. Arifi, përmbarues privat i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (në tekstin e mëtejme: Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Procedurën Përmbartimore), në ndërlidhje me nenin 247 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, nr. 04-L/139 (në tekstin e mëtejme: Ligji për Procedurën Përmbartimore).
3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se neni 22, paragrafi 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Procedurën Përmbartimore, i cili ka bërë amendamentimin e nenit 234 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, është në kundërshtim me nenin 247 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, si dhe është diskriminues dhe në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 77 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 17 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) një letër të titulluar *“Aktpërcjellës për dorëzimin e lëndës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës,”* si dhe dorëzoi dosjen e një lënde përmbartimore.
6. Më 19 shtator 2018, Gjykata i dërgoi një shkresë parashtruesit të kërkesës, duke kërkuar që të qartësojë kërkesën e tij dhe të saktësojë bazën ligjore për parashtrimin e kërkesës së tij.
7. Më 1 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një shkresë me të cilën informoi Gjykatën që kërkesën po e parashtron bazuar në nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës. Në këtë shkresë, parashtruesi theksoi se kërkesa e tij, si organ përmbartues, *“nuk është kërkesë individuale, por bëhet fjalë për një lëndë konkrete gjyqësore/përmbartimore”*.
8. Më 5 nëntor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
9. Më 30 nëntor 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Gjykata, po të njëjtën ditë, e njoftoi edhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që të njoftojnë Gjykatën me informata përkatëse lidhur me kërkesën (çështjen) e parashtruesit të kërkesës.
10. Gjykata Supreme nuk ka dorëzuar asnjë dokument apo informacion lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës.

11. Më 22 korrik 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton që debitorët M. A. dhe L. A. (në tekstin e mëtejme: debitorët) kishin lidhur kontratë për kredinë me kreditorin, përkatësisht ProCredit Bankën (në tekstin e mëtejme: kreditori). Debitorët kishin vënë në hipotekë një paluajtshmëri të tyre (parcelë tokësore), e cila gjendet në fshatin Pozharan, komuna e Vitisë.
13. Si pasojë e mospagesës së një pjese të kredisë, lënda e debitorëve u procedua në procedurë të përmbarimit në Gjykatën Themelore në Gjilan-dega në Viti dhe u evidentua me numër të lëndës E. nr. 1041/2012.
14. Më 31 janar 2013, u shpall në Gazetën Zyrtare, Ligji për Procedurën Përmbarimore. Me këtë Ligj, kompetent për zbatimin e procedurës përmbarimore u caktuan, përpos gjykatave, edhe përmbaruesit privat.
15. Në një datë të pacaktuar, kreditori kërkon nga Gjykata Themelore në Gjilan-dega në Viti, që lënda të bartet tek përmbaruesi privat [parashtruesi i kërkesës].
16. Më 17 prill 2015, Gjykata Themelore në Gjilan-dega në Viti nxori Konkluzionin E. nr. 1041/2012, me të cilin miratoi kërkesën e kreditorit për bartjen e lëndës tek përmbaruesi privat, gjegjësisht parashtruesi i kërkesës.
17. Më 24 prill 2015, parashtruesi i kërkesës dërgoi Konkluzionin P. nr. 159/15 tek debitorët dhe i informoi ata se lënda përmbarimore, E. nr. 1041/2012, është bartur nga Gjykata tek ai (si përmbarues privat).
18. Më 22 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës përpiloi Procesverbalin P. nr. 159/15, për shitjen e paluajtshmërisë (hipotekës) së debitorëve, në ankandin e I-rë publik verbal për shitjen e paluajtshmërisë. Në seancën e ankandit të I-rë nuk kishte asnjë ofertues për blerjen e paluajtshmërisë.
19. Më 21 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës përpiloi Procesverbalin P. nr. 159/15, për shitjen e paluajtshmërisë në ankandin e II-të publik verbal. Në këtë seancë, përsëri, nuk ishte paraqitur askush për blerjen e paluajtshmërisë dhe pjesëmarrës ishin vetëm parashtruesi i kërkesës dhe kreditori. Si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës në të njëjtën datë përpiloi një konkluzion dhe urdhër.
20. Në konkluzion, parashtruesi i kërkesës fillimisht konstatoi se nuk është paraqitur asnjë ofertë nga blerësit e mundshëm. Kreditori u shpreh se në ankandin e II-të nuk do të ofertojë për blerjen e paluajtshmërisë, mirëpo propozoi që pronat e hipotekuara t'i kalojnë atij në pronësi. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës njoftoi kreditorin se *“dispozita e nenit 234, paragrafi 3 [neni 22 paragrafi 3] të Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Procedurën Përmbarimore është në kontradiktë me nenin 247 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore”*. Lidhur me kundërthënien e pretenduar në mes

këtyre neneve, parashtruesi theksoi se Oda e Përmbaruesve Privat e Republikës së Kosovës do të dërgojë në Gjykatën Supreme kërkesë për mendim juridik se cila dispozitë zbatohet në rastet kur kemi të bëjmë me kërkesën e kreditorit për dorëzimin e paluajtshmërisë tek kreditori.

21. Pas këtij konkluzioni, parashtruesi i kërkesës lëshoi një urdhër me katër pika, me të cilin: (1) *Refuzohet kërkesa e përfaqësuesit të kreditorit për dorëzimin e paluajtshmërisë, bazuar në atë se paragrafi 3, i nenit 234 të Ligjit nr.05/L-118, për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, është në kundërshtim me dispozitën e nenit 247 të Ligjit Bazik të Procedurës Përmbarimore nr. 04/L-139, si dhe paragrafi i njëjtë, është dispozitë diskriminuese ndaj debitorit, pasi që e dëmton shumë debitorin në aspektin material dhe si një dispozitë të tillë nuk mund të zbatohet pasi që [është] në kundërshtim me Kushtetutën [...]. Përmes pikës (2) të Urdhrit, parashtruesi i kërkesës theksoi se refuzimin e kërkesës së debitorit sipas pikës (1) e merr në pajtim me nenin 9, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore i cili e obligon organin përmbarues të mbrojë dinjitetin e debitorit. Në pikën (3) të Urdhrit në fjalë, parashtruesi i kërkesës vendosi që “[...] çështjen e përputhshmërisë kushtetuese të ligjit për procedurën përmbarimore ta dërgoj në Gjykatën Kushtetuese [...] në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës [...], dhe me pikën (4) parashtruesi konstatoi se “[...] pas marrjes së vendimit nga Gjykata Kushtetuese [...] për çështjen e pajtueshmërisë së dispozitës ligjore, përkatësisht paragrafit 3 të nenit 234 të Ligjit nr. 05/L-118, për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, do t’i njoftojë të gjitha palët në procedurë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese [...]”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me jokushtetutshmërinë e nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Procedurën Përmbarimore (i cili ka bërë amendamentimin e nenit 234 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore), në ndërlidhje me nenin 247 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, këto nene janë kundërthënëse, diskriminuese dhe e dëmtojnë debitorin.
23. Parashtruesi i kërkesës thekson se ai po e dorëzon një “[...] lëndë gjyqësore-përmbarimore për një rast konkret”. Sipas parashtruesit të kërkesës, kjo lëndë është “[...] shtjelluar në Procesverbalin e seancës numër P. nr. 159/15, i datës 21.09.2017”.
24. Parashtruesi i kërkesës më tej argumenton se “Lënda gjyqësore/përmbarimore Ekz. nr. 1041/2012, është transferuar nga Gjykata Themelore në Gjilan-dega në Viti në Zyrën e Organit Përmbarues konform nenit 397, paragrafi 4 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore ku përcaktohet se veprimet në procedurën e përmbarimit të ndërmarra nga Gjykata janë të vlefshme ligjërisht sikurse të ishin marrë nga përmbaruesi i cili vazhdon përmbarimin”.

25. Parashtruesi pohon se bazuar në Procesverbalin P. nr. 159/15, të 21 shtatorit 2017, ka konstatuar se neni 22, paragrafi 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Procedurën Përmbarimore është në kundërtë me nenin 247 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore dhe këto nene diskriminojnë debitorin si palë në procedurë, për shkak se ai dëmtohet në masë të madhe materialisht. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se [...] “nuk është i sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën”.
26. Në lidhje me mbrojtjen e debitorit në procedurë, parashtruesi i referohet nenit 9, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, sipas të cilit organi përmbarues detyrohet që “[...] gjatë zbatimit të përmbarimit të mbrojtje dinjitetin e debitorit dhe përmbarimi të jetë sa më pak i dëmshëm për të”.
27. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që “[...] për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar që mund të bëhet shkelje e Kushtetutës, lidhur me rastin konkret, si dhe rastet e ardhshme eventuale që mund të pasojnë si rezultat i aplikimit të kësaj dispozite ligjore diskriminuese, të fillojë procedurën e vlerësimit të kushtetutshmërisë”.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

i) Nenet përkitazi me palën e autorizuar

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 102

[Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]

1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat.
2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.

LIGJI Nr. 03/L-199 PËR GJYKATAT

Neni 3

[Pavarësia dhe paanshmëria e Gjykatave]

1. Gjykatat e themeluara me këtë ligj gjykojnë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.
2. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit dhe marrjes së vendimeve janë të pavarur, të paanshëm, të pandikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik, përfshirë edhe organet publike.

Neni 4

[Ushtrimi i Pushtetit Gjyqësor]

Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat e themeluara me këtë ligj. Gjykatat e themeluara me këtë ligj janë: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.

LIGJI Nr. 06/L – 054 PËR GJYKATAT (i miratuar në Kuvend më 28 nëntor 2018 dhe i publikuar në Gazetën Zyrtare më 18 dhjetor 2018)

*Neni 3
Ushtrimi i Pushtetit Gjyqësor*

1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat e themeluara me këtë ligj.
2. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik, i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.

*Neni 8
[Struktura organizative]*

1. Sistemi i gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.
2. Degët themelohen brenda territorit të një Gjykate Themelore. Themelimi i degëve të reja, apo i departamenteve të cilat nuk janë përcaktuar në këtë ligj, apo bashkimi i degëve, bëhet vetëm me ligj.

LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

*Neni 2
[Përkufizimet]*

[...]

- 1.11. Përmbaruesi privat-personi fizik i emëruar nga Ministri i Drejtësisë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, i cili në kryerjen e autorizimeve publike të besuara sipas këtij ligji, vendos për veprimet nga kompetenca e tij në zbatimin e përmbarimit të lejuar dhe ndërmerr veprime për përmbarim.

*Neni 323
[Statusi dhe kompetencat e përmbaruesit privat]*

1. Përmbaruesi privat për kryerjen e autorizimeve publike të besuara me këtë ligj emërohet nga Ministri i Drejtësisë (më tutje: Ministri) për territorin e Gjykatës Themelore.
2. Përmbaruesi privat është kompetent të ndërmarrë të gjitha veprimet të përcaktuara në nenin 341 të këtij ligji dhe veprime të tjera të lejuara apo përcaktuara për përmbaruesin privat sipas këtij ligji, përveç kur shprehimisht ndalohen me këtë ligj.

*Neni 341
[Detyrat e përmbaruesit privat]*

1. Përmbaruesi privat në procedurën e caktimit dhe të zbatimit të përmbarimit, në pajtim me dispozitat dhe kufizimet e parapara me këtë ligj:

- 1.1. nxjerrë urdhër për përmbarim dhe zbaton përmbarimin në pajtim me autorizimet e tij;
- 1.2. pranon dhe vepron sipas propozimeve për përmbarim të kërkesave dhe të propozimeve për zbatim të përmbarimit të kërkesave dhe cakton mënyrën e përmbarimit nëse kreditori nuk e ka caktuar në propozim;
- 1.3. të dorëzojë urdhra, akte, dhe shkresa;
- 1.4. të identifikojë palët dhe pjesëmarrësit në procedurën përmbarimore;
- 1.5. të mbledh të dhëna për gjendjen pasurore të debitorit;
- 1.6. të nxjerrë konkluzione, përpilojë procesverbale, kërkesa dhe të dhëna tjera zyrtare në pajtim me autorizimet e parashikuara me këtë ligj;
- 1.7. të kryejë regjistrimin, vlerësimin e pronës, sekuestrimin dhe shitjen e pasurisë së luajtshme dhe të drejtave mbi pasurinë e paluajtshme;
- 1.8. të pranojë dhe ruajë pasurinë e regjistruar dhe të siguruar të debitorit, urdhërojë transferin e pronësisë dhe kryejë ndarjen e pasurisë dhe mjetet tjera monetare të realizuara me shitjen e pasurisë;
- 1.9. të kryejë zhvendosjen dhe veprimet tjera përmbarimore për qëllime të përmbarimit në pajtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore;
- 1.10. sipas kërkesës së debitorit apo kreditorit, përmbaruesi privat ndërmjetëson ndërmjet tyre për qëllime të arritjes së marrëveshjes;
- 1.11. të pranojë dhe transferoj mjete monetare në pajtim me këtë ligj;
- 1.12. të mbajë evidencë të rasteve në të cilat ai vepron në pajtim me formën e përcaktuar nga Ministri;
- 1.13. të ndërmarrë veprime të tjera siç parashikohet me këtë ligj të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

ii) Nenet e ligjit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës

LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

Neni 247

[Përmbushja e kredisë me dorëzimin e paluajtshmërisë kreditorit]

1. Në qoftë se paluajtshmëria nuk shitet as në seancën e tretë të ankandit publik, ose me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë brenda afatit të caktuar nga organi përmbarues, me kërkesën e propozuesit të përmbarimit, organi përmbarues me aktvendim mund t'ia dorëzojë paluajtshmërinë vetë propozuesit të përmbarimit.
2. Në rastin nga paragrafi 1. i këtij neni, konsiderohet se kredia e kreditorit është përmbushur deri në shumën e cila i përgjigjet dy të tretave të vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë.

**LIGJI NR. 05/L-118 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
LIGJIT NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE**

Neni 22

Neni 234 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

[...]

3. Në qoftë se paluajtshmëria nuk ka mundur të shitet as në ankandin e dytë, atëherë me propozim të kreditorit, organi përmbarues merr vendim që

paluajtshmëria t'i dorëzohet kreditorit duke kaluar në pronësi të tij, me ç'rast edhe kërkesa ndaj debitorit konsiderohet si e përmbushur në tërësi.
[...]

Neni 27

Neni 247 i ligjit bazik, paragrafi 1., fjala "e tretë", zëvendësohet me fjalën "e dytë"

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata duhet fillimisht të shqyrtojë nëse janë plotësuar kriteret për pranueshmëri të kërkesës, të parashikuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet fillimisht paragrafit 1 dhe 8, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili parasheh:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]

8. Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë".

30. Më tej, Gjykata i referohet neneve 51, 52, 53, të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 51 [Saktësimi i kërkesës]

1. Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.

2. Kërkesa do të specifikojë cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.

Neni 52 [Procedura para gjykatës]

Pas ngritjes së kërkesës në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, procedura para gjykatës referuese do të suspendohet deri në nxjerrjen e një vendimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Neni 53 [Vendimi]

Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për pajtueshmërinë e dispozitës ligjore me Kushtetutën dhe nuk vendos për çështje të tjera faktike ose juridike që kanë të bëjnë me kontestin para gjykatës referuese.

31. Gjykata i referohet edhe rregullit 77 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Neni 77 [Kërkesa në pajtim me nenin 118.8 të Kushtetutës dhe nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit]

(1) Kërkesa e ngritur sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.8 të Kushtetutës dhe me nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit.

(2) Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë një kërkesë sipas këtij rregulli, me kusht që:

(a) ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërdrejtë nga gjykata në lidhje me çështjen në pritje; dhe

(b) ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për vendimin lidhur me rastin në pritje të gjykatës.

(3) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të specifikojë se cilat dispozita të ligjit të kontestuar konsiderohen të papajtueshme me Kushtetutën. Dokumenti i shqyrtuar nga gjykata i bashkëngjitet kërkesës.

(4) Gjykata referuese mund të parashtrojë kërkesë ex officio ose me kërkesën e njëres prej palëve në rast dhe pavarësisht nëse një palë në rast ka kontestuar kushtetutshmërinë e dispozitës përkatëse ligjore.

(5) Pas parashtrimit të kërkesës, Gjykata urdhëron gjykatën referuese që të pezullojë procedurën lidhur me rastin në fjalë deri sa të merret vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

32. Duke iu referuar dispozitave të lartpërmendura, Gjykata duhet që fillimisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të parashtruar një kërkesë të tillë, përkatësisht a është dorëzuar kërkesa nga "gjykata" në kuptim të nenit 113.8 të Kushtetutës.

33. Gjykata fillimisht i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe sjellë në vëmendje se deri më tani ka pasur 5 (pesë) raste ku kërkesat janë parashtruar duke u bazuar në paragrafin 8, të nenit 113 të Kushtetutës (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: KO04/11, parashtrues *Gjykata Supreme e Kosovës* Aktgjykim i 1 marsit 2012; rastin KO59/14 parashtrues *Hilmi Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 14 korrikut 2014; rastin KO126/16, gjykata referuese *Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme* për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit Aktvendim për papranueshmëri, i 27 marsit 2017; si rastin KO142/16, gjykata referuese *Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme* për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të

Privatizimit Aktgjykim i 9 majit 2017 dhe rastin KO157/18, gjykata referuese Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 13 marsit 2018).

34. Në praktikën e saj, Gjkata ka përcaktuar që e drejta e gjykatave të rregullta për të referuar kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së normave juridike buron nga neni 113, paragrafi 8 i Kushtetutës, por se në përputhje me këtë nen, palë e autorizuar konsiderohet “*gjkata*” (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KO59/14, cituar më lart p. 55). Këtë qëndrim Gjkata e arsyetoi duke u referuar në dallimin që e bënë Kushtetuta dhe Ligji për Gjykatat, në mes të “*gjkatave*” dhe “*gjyqtarëve*”.
35. Më tej, në aktvendimin e saj në rastin KO126/16, Gjkata konstatoi se secila përbërje e gjykatës së rregullt që ka kompetencë për të gjykuar rastin konkret, është palë e autorizuar për të paraqitur kërkesë në përputhje me nenin 113.8 të Kushtetutës dhe këtë Gjkata e konstatoi dhe në Aktgjykimin KO142/16.
36. Në rastin konkret, Gjkata vëren se kërkesa është referuar nga parashtruesi i kërkesës në cilësinë e organit përmbarues, përkatësisht përmbaruesit privat. Parashtruesi i kërkesës pretendon se rasti pranë nesh është lëndë konkrete “*gjyqësore/përmbarimore*” dhe si i tillë duhet të shqyrtohet në bazë të nenit 113.8 të Kushtetutës.
37. Gjkata rikujton se parashtruesi i kërkesës pohon që zbatimi i nenit 22, paragrafi 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Procedurën Përmbarimore është në kundërtënie me nenin 247 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Kjo kundërtënie e neneve, sipas parashtruesit të kërkesës: i) diskriminon debitorin si palë në procedurë për shkak se debitori dëmtohet në masë të madhe materialisht dhe ii) si rrjedhojë e këtij diskriminimi, është kundërkushtetues.
38. Duke iu referuar pretendimeve të parashtruesit, Gjkata rikujton se qëllimi parësor i nenit 113.8 të Kushtetutës, përkatësisht i të ashtuquajturit “*kontrollit incidental i kushtetutshmërisë,*” është shmangia e situatave të paqarta lidhur me respektimin e parimit të kushtetutshmërisë, si një prej parimeve themelore të rendit juridik, që imponon pajtueshmëri të plotë dhe të tërësishme të ligjeve (dhe akteve të tjera normative) me Kushtetutën. Mirëpo, si kusht themelor për pranueshmëri të një kërkesë për “*kontroll incidental të kushtetutshmërisë*” është që kjo kërkesë të parashtrohet nga pala e autorizuar, përkatësisht nga një “*gjkatë*”.
39. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës është përmbarues privat i cili emërohet nga Ministri i Drejtësisë dhe ka kompetencë për kryerjen e autorizimeve sipas Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Gjkata rikujton se paragrafi 1 i nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, përcakton qartë që “*Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat*”. Për më tepër, Ligji i ri për Gjykatat (Ligji nr. 06/L – 054 për Gjykatat), përcakton në nenin 3 të tij që pushteti gjyqësor “[...] ushtrohet nga gjykatat e themeluara me këtë ligj” dhe në nenin 8 të këtij ligji përcaktohet që “*sistemi i gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga: Gjykatat Themelore, Gjkata e Apelit dhe Gjkata Supreme*”.

40. Gjykata, gjithashtu, vë në pah se fakti që parashtruesi i kërkesës kryen autorizime të përcaktuara me ligjin përkatës për procedurë përmbarimore dhe arsyetimi i parashtruesit se konform nenit 397, paragrafi 4 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore *“veprimet në procedurën e përmbarimit të ndërmarra nga Gjykata janë të vlefshme ligjërisht sikurse të ishin marrë nga përmbaruesi i cili vazhdon përmbarimin”*, nuk nënkuptojnë që parashtruesi i kërkesës është pjesë e sistemit gjyqësor.
41. Për më tepër, Gjykata edhe në praktikën e saj gjyqësore, duke iu referuar të drejtës krahasuese, ka theksuar se një numër i madh i shteteve evropiane parasheh që “gjykatat e rregullta” janë të autorizuar të parashtrojnë kërkesë në gjykatat kushtetuese për të ashtuquajturin “kontroll incidental të kushtetutshmërisë” (Shih rastin KO126/16, cituar më lart, paragrafët 46-48).
42. Prandaj, bazuar në sa u tha më sipër, Gjykata konsideron se kërkesa e tanishme nuk është dorëzuar nga “gjykata” në kuptim të nenit 113.8 të Kushtetutës.
43. Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për paraqitjen e kërkesës dhe rrjedhimisht Gjykata shpall kërkesën të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullit 59 (b) të Rregullores së punës, më 22 korrik 2019, njëzëri


VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi

